REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 692120
Datë/Datum. 12.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Blerina Huruglica ***Ekspert Shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***30.09.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***12.10.2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **21.09.2020. OE "Integral SHPK&Milenium Konstruktion SHPK"**, ka parashtruar ankesë me nr: **692/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE " Saba Belca& SB Construction SHPK& Gurëbardhi SHPK"** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë"** me nr të prokurimit **616-19-1015-5-1-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINE.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **2.385.143,51€**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë 02.12.2019, data e hapjes së ofertës 26.12.2019, data e njoftimit për dhënien e kontratës 07.09.2020, data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm 07.09.2020

Lënda është e përsëritur, lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.**317/20** i dt: 10.07.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit:

Të nderuar njoftimin mbi vendimin e AK-së e kemi pranuar me dt.07.09.2020 ku e ka rekomanduar për kontratë OE Saba Belca Dega në Kosovë & SB Construction Shpk & Gurëbardbi Shpk, ndërsa neve na ka eliminuar me

arsyetimin se *"nuk kemi dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se kemi përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (ndërtim i ulët) në vlerë minimale prej 3,000.000.00 euro në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë".*

Fillimisht ju rikujtojmë se në vlerësimin e parë që AK-ja e kishte bërë dhe në njoftimin mbi vendimin e AK-së të dt.04.03.2020 e kishte rekomanduar për kontratë të njëjtin operator ekonomik, sikurse tani, ndërsa neve na kishte eliminuar po me të njëjtën arsye sikurse tani. Ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt.06.03.2020, ndërsa AK-ja me dt.09.03.2020 kishte nxjerr vendimin ku na ka aprovuar kërkesën për rishqyrtim dhe aktivitetin në fjalë e kishte kthyer në rivlerësim.

Me kërkesë për rishqyrtim ne i kishim sqaruar AK-së në detaje kontratat për punë të ngjashme dhe i kishim bashkangjitur me kërkesë për rishqyrtim edhe pozicionet brenda kontratave e ku në këto pozicione janë kryer punime dhe ndërtime të rrugëve, e të cilat pozicione autoriteti kontraktues i kishte marr parasysh me rastin e rishqyrtimit dhe rivlerësimit.

Më pastaj AK-ja ka nxjerr njoftimin mbi vendimin tjetër ku na ka rekomanduar neve për kontratë. Pas këtij njoftimi kishte parashtruar ankesë në OSHP operatori ekonomik Saba Belca Dega në Kosovë & SB Construction Shpk & Gurëbardhi Shpk.

Eksperti shqyrtues i OSHP-së në raportin e tij të dt.11.06.2020 kishte rekomanduar që të refuzohet ankesa e OE ankues si e pa bazuar, ndërsa kishte rekomanduar që ky aktivitet të vazhdonte më tutje me procedurat e rregullta.

Ndërsa paneli shqyrtues me vendimin Nr.317/20 të dt. 10.07.2020, në kundërshtim me ekspertizën, kishte aprovuar pjesërisht ankesën ndërsa kishte vendosur që ky aktivitet të kthehet në rivlerësim, mirëpo tek arsyetimi i vendimit kishte vendosur dhe obliguar AK që gjatë rivlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me natyrën e punëve dhe nëse kontratat e kontestuara janë brenda 3 viteve të fundit sikurse ka kërkuar AK në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit. Pas sqarimeve të natyrës së këtyre kontratave dhe afateve, AK të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Duke u bazuar në vendimin e lartpërmendur të OSHP-së vërehet qartë dhe kuptohet se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar këtë vendim të OSHP-së edhe pse janë të obliguar ta bëjnë një gjë të tillë. Ne e plotësojmë këtë kërkesë edhe pa sqarime shtesë, mirëpo vendimi i panelit shqyrtues e ka obliguar AK të kërkoj sqarime shtesë, prandaj AK-ja është dashur ta respekton vendimin e OSHP-së, e jo të na eliminoj në mënyrë arbitrare dhe me supozime.

Veprimi i tanishëm i AK-së për të na eliminuar neve, jo vetëm që është në kundërshtim me vendimin e OSHP-së por është edhe në kundërshtim edhe me vendimin e mëparshëm të AK-së ku na kishte rekomanduar për kontratë, pra autoriteti kontraktues po përdor standarde të dyfishta në këtë aktivitet të prokurimit, herë duke na pranuar dëshmitë në lidhje me kontrata, e herë duke në eliminuar dhe duke mos na marr parasysh dëshmitë për kontrata të ngjashme.

Se AK-ja po përdor standarde të dyfishta në procese të prokurimit e dëshmon edhe fakti se AK-së në një aktivitet të prokurimit-ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse me nr.prok: 616-20-2390-511 i ishte parashtruar një pyetje si në vijim, citojmë 'Në *nenin 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional, ku kerkohet "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, punë, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë),,,,.*

A pranohen referencat e tenderëve të mirëmbajtjes së rrugëve, duke pasur parasysh faktin se në këto projekte ka edhe intervenime të ndryshme në trupin e rrugës dhe po ashtu shtruarje të asfaltit në pjesën qarkulluese të rrugës.?, mbarim citati.

Ndërsa përgjigja nga ana e AK-së kishte qenë si në vijim, citojmë *"Po, mund të pranohen, por duhet të specifikohen dhe të dëshmohen dëshmitë (pozicionet e paramasave të kontratës si dhe vlerat e pozicioneve në mënyrë që të dihet qartë për punët e kryera dhe vlerën e kryerjes së punëve",* mbarim citati.

Pra duke u bazuar në këtë sqarim, që vetë AK-ja e ka bërë dhe AK-ja e ka përdor si një standard në raste tjera, atëherë duhet që këtë standard ta përdor edhe në këtë aktivitet të prokurimit, e ku normalisht ne duhet të shpallemi

fitues, e jo të përdoret ky standard vetëm kur AK-ja e konsideron se duhet të përdoret, pra në mënyrë subjektive.

Bashkangjitur e keni edhe pyetjet dhe përgjigjet në lidhje me aktivitetin e prokurimit "ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse me nr.prok: 616-20-2390-511.

Sa për informacion ju sqarojmë se edhe raporti i komisionit të vlerësimit nuk është i nënshkruar prej tre anëtarëve të komisionit vlerësues ashtu siç kërkohet me ligj, mirëpo njëri anëtar i komisionit nuk e ka nënshkruar fare këtë raport e ky person është z. Ylber Jashari.
Në raportin e komisionit të vlerësimit shkruan se mbështetet edhe në vendimin e paneli shqyrtues që sqaron se kontratat e dorëzuara janë kontrata të mirëmbajtjes, mirëpo për neve është e çuditshme se si e kanë shënuar se mbështeten në vendimin e panelit shqyrtues, kur ky komision nuk ka marr për bazë vendimin e panelit shqyrtues i cili e ka obliguar AK të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së në lidhje me kontratat.
Në raport të vlerësimit shkruan se dëshmi për punë të ngjashme kemi ofruar në vlerën prej:2,173,499.89 €. Ky arsyetim është shumë i pasaktë dhe jo real dhe nuk e dimë se si AK-ja i ka bërë këto përllogaritje apo vetëm ka vepruar me supozime dhe në mënyrë subjektive duke e favorizuar OE e rekomanduar për kontratë.

Sa i përket arsyes së eliminimit nga ana e AK-së, ju sqarojmë se nuk është i qëndrueshëm ky arsyetim sepse ne kemi ofruar dëshmi se kemi realizuar kontrata në vlerë mbi 3,000.000.00 euro (më shumë se sa është kërkuar në FDT) dhe me dosje i keni pasur të bashkangjitura të gjitha dëshmitë si procesverbalet e pranimeve teknike, kontratat, referencat, e ku shumë lehtë AK-ja ka mundur të verifikoj një gjë të tillë vetëm se është dashur të bëj një vlerësim më objektiv dhe jo të njëanshëm.

AK-ja në FDT ka kërkuar që të ofrohen dëshmi për kontrata të ngjashme (ndërtim i ultë) në vlerë minimale 3,000.000.00 euro, ndërsa tek dëshmitë dokumentare ka kërkuar vetëm një listë të kontratave dhe me ju bashkëngjit referencat dhe procesverbalet pranimeve teknik. Pra si kërkesë ka dykuptimësi sepse tek kërkesa shkruan të ngjashme ndërsa në kllapa ndërtim i ultë.

Termi kontrata të ngjashme është term shumë i zgjeruar dhe mund të merren edhe mirëmbajtja e rrugëve, ashtu siç e ka bërë AK-ja në një përgjigje që e cekëm më lartë. Mirëpo sidoqoftë edhe nëse eventualisht nuk i ka llogaritur si të ngjashme mirëmbajtjen e rrugëve atëherë kërkojmë nga ju që të detyroni AK që në kontratat që ne i kemi prezantuar me titull mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve-magjistraleve dhe autostradave, në brendi të tyre në paramasë ka pozicione që janë kryer ndërtim të rrugëve, asfaltim, gërmim, bankina, pahije elastik, kanalizime, mure gabione, sinjalizim etj. ti merr parasysh dhe ti konsiderojë në kuadër të ndërtimit të rrugëve-ndërtimit të ulët.

Kontratat e mirëmbajtjes janë kontrata të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo ne ju sqarojmë se në kontratat të cilat ne i kemi realizuar për mirëmbajtje ka pasur shumë punë në pozicione dhe në paramasë e që ne i kemi kryer si p.sh furnizimi me asfalt, gropëzimi etj. Gjithashtu ju sqarojmë se ne kontratat për mirëmbajtje i kemi për rrugë nacionale dhe regjionale, ku ka shumë punë edhe në riparimin dhe sanimin e dëmtimeve të mëdha të asfaltit, gabiona, pahi etj.
Po ashtu kontratat e prezantuara nga ne janë edhe për mirëmbajtjen dhe punët e kryera në Autostradën Ibrahim Rugova, ku janë të përfshira shumë pozicione që kanë të bëjnë me asfalt, kanalizim, gërmim, mbushje me zhavorr etj.

Prandaj me mirësjellje kërkojmë nga ju që të detyroni AK që ti analizojnë kontratat e mirëmbajtjes në brendi, e ne po ju bashkëngjisim edhe njëherë kontratat përkatëse e ku në brendi janë të nënvizuara me marker pozicionet të cilat janë kryer e që hyjnë në kuadër të ndërtimit të ulët, siç u cek më lartë e ku vërtetohet se shuma e kryer e këtyre pozicione është shumë e lartë dhe e tejkalojmë vlerën e kërkuar për tri vitet e fundit.
Gjithashtu ju si OSHP ne shumë vendime keni marr për bazë pozicionet përkatëse në kuadër të kontratave dhe i keni llogaritur vlerat e këtyre pozicione për të bërë vlerësim real faktik.
Po ashtu vetë AK-ja në përgjigjen që e cekëm më lartë ka theksuar se duhet të speciflkohen dhe të dëshmohen dëshmitë (pozicionet e paramasave të kontratës si dhe vlerat e pozicioneve në mënyrë që të dihet qartë për punët e

kryera dhe vlerën e kryerjes së punëve)

AK-ja e ka rekomanduar për kontratë OE i cili është i papërgjegjshëm dhe i cili ka ofertuar me çmim më të lartë se sa oferta jonë. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm **sepse licenca e SB Construction është leje e hulumtimit me afat të skaduar pasi që shihet qartë se vlefshmëria i ka skaduar me dt.27.01.2019.**
Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka të nënshkruara paramasat dhe çmimet, ndërsa i njëjti ka ofruar dy paramasa me dy çmime, prandaj është dashur të eliminohet si ofertues i papërgjegjshëm.

Ne me dt. 14.09.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë lonë për rishqyrtim.
AK-ja në arsyetimin e saj e ka cekur se janë marrë për bazë punimet nga kontratat e mirëmbajtjes të cilat janë pranuar në bazë të kërkesës tonë, por janë në kundërshtim me vendimin e OSHP-së dhe se çfarëdo konstatimi i AK-së është në kundërshtim me vendimin e OSHP-së duhet të ç'fuqizohet, mirëpo ju sqarojmë se ky arsyetim është shumë absurd për faktin se në vendimin e OSHP-së nuk është cekur asnjëherë se kontratat e mirëmbajtjes nuk janë të ngjashme, por është cekur qartë se duhet të kërkohen sqarime në lidhje me këto kontrata, mirëpo edhe pse AK-ja ka qenë e obliguar të na kërkojë sqarime shtesë, nuk e ka bërë këtë veprim fakt ky që tregon se nuk është respektuar vendimi i OSHP-së. Andaj ky arsyetim i AK-së është absurd për faktin se si ka mundësi të pranohen kontratat e lartcekura nga ana e AK-së dhe pastaj të mos rekomandohemi për kontratë, prandaj ky referim i AK-së se kontratat janë në kundërshtim me vendimin e OSHP-së është i pa bazuar, pasi që OSHP-ja e kishte obliguar AK që gjatë rivlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me natyrën e punëve dhe nëse kontratat e kontestuara janë brenda 3 viteve të fundit ndërsa pas sqarimeve të natyrës së këtyre kontratave dhe afateve, AK të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar.

Sa i përket arsyes tjetër të AK-së ku e ka cekur se komisioni i rivlerësimit ka konstatuar se edhe nëse kontratat janë të pranueshme ju nuk e plotësoni kërkesën në vlerën e kërkuar, është e pa bazuar sepse ne i kemi ofruar dëshmitë si procesverbalet e pranimeve teknike, kontratat, referencat, e ku shumë lehtë AK-ja ka mundur të verifikoj një gjë të tillë vetëm se është dashur të bëj një vlerësim më objektiv dhe jo të njëanshëm, siç ka vepruar edhe tani në vendimin për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim. Gjithashtu në raport të vlerësimit shkruan se dëshmi për punë të ngjashme kemi ofruar në vlerën prej:2,173,499.89 €. Ky arsyetim është shumë i pasaktë dhe jo real dhe nuk e dimë se si janë bërë këto përllogaritje apo vetëm është vepruar me supozime dhe në mënyrë subjektive.

Në lidhje me arsyetimin e AK-së ku ne e kemi cekur se AK-ja ka përdor standarde të dyfishta, autoriteti kontraktues e ka cekur se kjo nuk ka të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo edhe ne e dimë që nuk ka të bëjë pikërisht me këtë aktivitet mirëpo ka të bëjë me autoritet të njëjtë dhe qështje të njëjta është, pasi që në kërkesën për sqarime AK-së i ishte kërkuar që të sqaron se *A pranohen referencat e tenderëve të mirëmbajtjes së rrugëve, duke pasur parasysh faktin se në këto projekte ka edhe intervenime të ndryshme në trupin e rrugës dhe po ashtu shtruarje të asfaltit në pjesën qarkulluese të rrugës?* Ku AK-ja e ka cekur shumë qartë se po pranohen edhe pse natyra e kontratës është e njëjtë me aktivitetin e tanishëm. Pra këtu shihet qartë se pretendimi ynë nuk është tendencioz siç ka pretenduar AK-ja mirëpo është i bazuar.
Gjithashtu AK-ja nuk e ka sqaruar fare pretendimin tonë në lidhje me njërin nga anëtarët e komisionit vlerësues ku e kemi cekur se raporti i komisionit të vlerësimit nuk është i nënshkruar prej tre anëtarëve të komisionit vlerësues ashtu siç kërkohet me ligj.
Më poshtë i gjeni tabelat në lidhje me kontratat e realizuara nga kompania Integral dhe Milenium si anëtarë të konzorciumit ofertues në këtë aktivitet të prokurimit.
Në këto tabela janë të sqaruara në detaje të gjitha kontratat për tri vitet e fundit me vlerat totale e po ashtu janë të sqaruara në detaje edhe punët e kryera në lëminë e ngjashme ashtu siç është kërkuar nga autoriteti kontraktuese, e ku shihet se vlera e punëve të ngjashme e kalon vlerën e kërkuar, edhe pse vetë AK-ja i pranon edhe kontratat e mirëmbajtjes si kontrata të natyrës së ngjashme në aktivitet tjera, ashtu siç e cekëm më lartë edhe një sqarim të kërkuar nga një operator ekonomik, e ku AK-ja e kishte konfirmuar se *mund të pranohen, por duhet të specifikohen*

dhe të dëshmohen dëshmitë (pozicionet e paramasave të kontratës si dhe vlerat e pozicioneve në mënyrë që të dihet qartë për punët e kryera dhe vlerën e kryerjes së punëve".

Pra AK-ja në raste të caktuara i pranon pozicionet në brendi të kontratave e që janë të natyrës së kërkuar, ndërsa tani, vetëm pse ne jemi në pyetje dhe vetëm pse ne mund të shpallemi fitues e përdor një standard tjetër duke na eliminuar neve dhe nuk i ka anlizuar dhe nuk i ka marr për bazë pozicionet të clat ne i kemi sqaruar dhe nënvizuar me marker se janë punë të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit.

Kontrata	Data e Fillimit te Kontrates	Data e Pranimit Teknik te Kontrates	Vlera e Kontrates	Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme.	Autoriteti Kontraktues
MV & MD e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës 2016/2017 – Regjioni i Prishtinës 2 -kontrate kornize	15.11.2016	16.01.2018	€ 1,276,428.34	€ 801,778.20	Ministria e Infrastruktures
Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shtedim (rruga pas restorant Evropa)	13.06.2017	23.08.2017	€ 131,663.82	€ 131,663.82	KK Podujevë
Asfalltimi i disa rrugëve dhe rrugicave në qytet (pjesa II)	17.10.2017	08.08.2018	€ 208,288.40	€ 208,288.40	KK Podujevë
Asfalltimi i disa rrugëve në fshatin Ballofc	20.11.2017	20.11.2018	€ 75,490.25	€ 75,490.25	KK Podujeve
Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Orzhana fshati Obrançë	27.08.2018	20.12.2019	€ 137,627.35	€ 137,627.35	K.K. Podujevë
Asfaltimi i rrugës Sollobajë-Bugurdoll-Majac	03.12.2018	26.11.2019	€ 58,444.88	€ 58,444.88	K.K. Podujevë
Asfaltimi i rrugës ne fshatin Sollobajë te Varrezat	08.08.2018	03.10.2018	€ 48,403.72	€ 48,403.72	K.K. Podujevë
Mirëmbajtja Verore dhe Dimerore e Rrugëve Magjistrale dhe Regjionale për vitin 2018/2019, Regjioni i Prishtinës 2	12.07.2018	12.07.2019	€ 1,508,379.34	€ 1,137,251.17	Ministria e Infrastruktures
GJITHSEJT VLERA E KONTRATAVE: 1.4.2017 - 26.11.2019			€ 3,444,726.10	€ 2,598,947.79	

****VEMENDJE****

- Vlera totale e kontratave të përfunduara të Kompanisë Integral Shpk në tri vitet e fundit nga shpallja e tenderit, kap vlerën prej 3,444,726.10 €

Vetëm vlera totale e punëve të ngjashme ne ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugëve në tri vitet e fundit nga shpallja e tenderit, kap vlerën prej 2,598,947.79 €

INTEGRAL SH.P.K. - Lista e Projekteve te Realizuara: nga data 26.11.2019 - 26.11.2016				
Kontrata	Data e Fillimit te Kontrates	Data e Pranimit Teknik te Kontrates	Vlera e Kontrates	Autoriteti Kontraktues
MV & MD e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës 2016/2017 – Regjioni i Prishtinës 2 - kontrate kornize	15.11.2016	16.01.2018	€ 1,276,428.34	Ministria e Infrastruktures
MV & MD e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës 2017/2018 – Regjioni i Prishtinës 2 - kontrate kornize	14.12.2017	16.04.2018	€ 379,189.76	Ministria e Infrastruktures

Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shtedim (rruga pas restorant Evropa)	13.06.2017	23.08.2017	€ 131,663.82	KK Podujevë
Asfalltimi i disa rrugëve dhe rrugicave në qytet (pjesa II)	17.10.2017	08.08.2018	€ 208,288.40	KK Podujevë
Asfalltimi i disa rrugëve dhe rrugicave në qytet (pjesa II)	21.09.2016	28.09.2017	€ 371,156.18	KK Podujevë
Asfalltimi i disa rrugëve në fshatin Ballofc	20.11.2017	20.11.2018	€ 75,490.25	KK Podujevë
Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Mërdar	03.08.2016	20.12.2016	€ 194,187.69	KK Podujevë
Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Orzhana Fshati Obrançë	27.08.2018	20.12.2019	€ 137,627.35	K.K. Podujevë
Asfaltimi i rrugës Sollobajë-Bugurdoll-Majac	03.12.2018	26.11.2019	€ 58,444.88	K.K. Podujevë
Asfaltimi i rrugës në fshatin Sollobajë te Varrezat	08.08.2018	03.10.2018	€ 48,403.72	K.K. Podujevë
Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Mërdar	03.08.2016	20.12.2016	€ 194,187.69	K.K. Podujevë
Asfaltimi i disa rrugëve në lagjen Ajeti në fshatin Sfeqël	04.10.2016	19.12.2016	€ 63,952.67	K.K. Podujevë
Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e Rrugëve Magjistrale dhe Regjionale për vitin 2015/2016, Regjioni i Prishtinës 2	15.11.2016	19.12.2016	€ 1,392,190.31	Ministria e Infrastrukturës
GJITHSEJT VLERA E KONTRATAVE: 26.11.2016 - 26.11.2019			**€ 4,531,211.06**	

Milenium Konstruction SH.P.K. - Lista e Projekteve te Realizuara: nga data 03.07.2017					
Kontrata	Data e Fillimit te Kontrates	Data e Pranimit Teknik te Kontrates	Vlera e Kontrates	Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme,	Autoriteti Kontraktues
Riparimi i rrugëve të asfaltuara (Sanimi i Gropave)	03.07.2017	02.11.2017	€ 46,115.11	€ 46,115.11	KK Podujevë
Asfaltimi I rruges ne lagjen Zijaqi - Idrizi Sekiraqë	31.07.2017	05.09.2017	€ 11,855.19	€ 11,855.19	KK Podujevë
Asfaltimi i disa rrugëve e rrugicave në fshatin Letanc, Sibofc, Lluga, Gllamnik, Sekiraqë dhe Dumnicë e Poshtme (loto II), PLUS Annex kontrata	07.11.2017	12.09.2018	€ 197,591.05	€ 197,591.05	KK Podujevë
Asfaltimi I disa rrugeve ne fshatin Gllamnik	07.11.2017	19.12.2017	€ 9,954.84	€ 9,954.84	KK Podujevë
Asfaltimi i disa rrugëve në Fshatin Lupç	21.11.2017	01.10.2018	€ 119,027.06	€ 119,027.06	KK Podujevë

Asfaltimi i rrugës në fshatin Repë dhe Peran	31.10.2018	26.11.2018	€ 48,495.50	€ 48,495.50	KK Podujevë
Asfaltimi I rruges lidhese Buricë - Penuhë dhe asfaltimi I disa rrugeve ne Sfeqël	27.11.2018	10.05.2019	€ 81,974.45	€ 81,974.45	KK Podujevë
Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Poshtme, Dobërdol, Bajqinë, dhe Majac PLUS ANNEX KONTRATA	05.06.2019	25.10.2019	€ 113,757.87	€ 113,757.87	KK Podujevë
Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Pakashticë e Epërme	19.07.2017	24.11.2017	€ 129,165.34	€ 129,165.34	KK Podujevë
Mirëmbajtja Rutinë dhe Mirëmbajtja Dimërore 2016-2017 e autoudhës "Ibrahim Rugova A7- segmenti Morinë – Gjurgjicë, Lot 1; dhe autoudhës A7-segmenti Bresje – Besi, Rrugës Nacionale N9, segmenti Bresje –Gjurgjicë-Udhëkryqit të Autoudhës A7/A6 deri në Konjuh dhe kyçja me Rrugën Nacionale N2-loti 2" Lot 2 e sipas kontrates dhe annex kontrates nr. ID. 010/2016, A1 010/2016 dhe A2 010/2016 per vitin 2017/2018. Kontratë kornizë tre (3) vjeqare	14.04.2017	14.05.2018	€ 1,230,166.77	€ 300,626.41	Ministria e Infrastrukturës
Mirëmbajtja Rutinë dhe Mirëmbajtja Dimërore 2016-2017 e autoudhës "Ibrahim Rugova A7- segmenti Morinë – Gjurgjicë, Lot 1; dhe autoudhës A7-segmenti Bresje – Besi, Rrugës Nacionale N9, segmenti Bresje –Gjurgjicë-Udhëkryqit të Autoudhës A7/A6 deri në Konjuh dhe kyçja me Rrugën Nacionale N2-loti 2", Lot 2 e sipas kontrates dhe annex kontrates nr. ID. 010/2016, A1 010/2016 per vitin 2018/2019. Kontratë kornizë tre (3) vjeqare	14.05.2018	24.04.2019	€ 961,041.32	€ 105,951.02	Ministria e Infrastrukturës
GJITHSEJT VLERA E KONTRATAVE: 03.07.2017 - 25.10.2019			€ 2,949,144.50	€ 1,164,513.84	

****VËMENDJE****

- Vlera totale e kontratave të përfunduara të Kompanisë Milenium Konstruction Shpk në tri vitet e fundit nga shpallja e tenderit, kap vlerën prej 2,949,144.50 €

Vetëm vlera totale e punëve të ngjashme në ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugëve në tri vitet e fundit nga shpallja e tenderit, kap vlerën prej 1,164,513.84 €

Pra kur llogariten vlerat e kontratave për tri vitet e fundit për të dy anëtarët e konzorciumit për punët e ngjashme në ndërtimin dhe rikonstruimin e rrugëve rezulton se është 3,763.461.63 €.
Bashkangjitur me tabelë i keni kontratat perkatëse, certifikatat e zhvillimit financiar, procesverbalet e pranimeve teknike etj, ku dëshmohet qartë se sa punë janë kryer brenda tri viteve të kërkuara nëpër kontratat të cilat kanë filluar më herët dhe dëshmohen pozicionet të cilat janë të nënvizuara me marker e ku shihet se këto pozicione janë të natyrës së ngjashine ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë dhe janë përfunduar brenda tri viteve të kërkuara.
Më tabelën e bashkangjitur më lartë dhe me dëshmitë të cilat i keni të bashkangjitura si sqarim shtesë dhe si sqarim lehtësues, eksperti shqyrtues dhe OSHP-ja e ka shumë të lehtë dhe shumë të qartë të vijë në përfundim se ne e plotësojmë kërkesën e AK-së për kontrata të natyrës së ngjashme në vlerë prej tre milion euro në tri vitet e fundit duke filluar prej njoftimit për kontratë, pra nga dt.26.11.2019.
Shumë të lehtë e ka pasur edhe AK-ja të bëjë një vërtetim dhe ekzaminim të saktë, mirëpo AK-së i ka munguar vullneti që të ndajë drejtësinë dhe të vlerësojë ofertën tonë ashtu siq duhet me ligj dhe konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Andaj duke u bazuar në të gjitha faktet e lartpërmendura shihet qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe duhet të rekomandohemi për kontratë dhe se pretendimet tona ankimore janë të bazuara.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka eliminuar neve edhe pse ne jemi OE më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Njëkohësisht AK-ja nuk e ka respektuar nenin 72 të LPP-së sepse nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga ne, nëse eventualisht ka pasur paqartësi sa i përket kontratave dhe referencave për vlerën e kërkuar. Sepse kjo lejohet edhe me nenin 59.2, 72 të LPP-së dhe me nenin 39 të RrUOPP. Madje nuk e ka respektuar edhe vendimin e OSHP-së Nr.317/20 të dt. 10.07.2020 ku janë obliguar që të kërkojnë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë dhe njëkohësisht është dashur ta ketë parasysh edhe nenin 6 të LPP-së përkatësisht ekonomicitetin dhe efikasitetin.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj Ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "Milenium Konstruction" Sh.p.k & "Integral" Sli.p.k
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së përdhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM, DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera

kompetente.

Dispozitat e shkclura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankuesit:

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Vendimi i OSHP-së Nr.317/20 i dt.10.07.2020

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakti 1: DT- kapacitetet teknike dhe profesionale 9.1&9.2

9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndertim i ulte) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1.Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Vetem pese OE kane vazhduar validitetin e ofertes:

Integral&Milenium
Gashi Ing
Saba Belce
Rexha
Pevlaku
Rekomandimi nga komisioni:
Raporti i rekomandimit të komisionit të vlerësimit për aktivitetin e prokurimit " Vazhdimi i rruges B- pjesa e II" me nr. 616 19 23 511

Gr-OE-INTEGRAL dhe MILENIUM KONSTRUKSION
Ofërte e papërgjegjshme (nuk plotëson kërkesat per Kapaciteti teknik dhe profesional)
Gr-OE- SABA BELCA dhe SB CONSTRUCTION dhe GURËBARDHI
Oferte e përgjegjshme
Gr-OE-GASHI ING dhe BAGERI
Oferte e përgjegjshme
Gr-OE-PE-VLAKU dhe JOOS & KRASNIQI
Oferte e përgjegjshme
Gr-OE-REXHA dhe RAHOVICA
Oferte e përgjegjshme

Ne funksion te vendimit te datës 31.08.2020, për vlerësimin e tenderit me titull "Vazhdimi i rrugës B pjesa e dyte" me nr.Teprokurimit 616-19-1015-511, japim rekomandimin si ne vazhdim:
Komisioni i vlerësimit ne mbështetje te kërkesave te dosjes se tenderit dhe njof'timit për kontrate dhc ne mbështetje te plote te vendimit te OSHP-se te datës 10.07.2020 me nr.317/20, ka bere ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertave për tenderin e larte përmendur.
Nga vlerësimi i bere i pese ofertave te dorëzuara nga zyrtaret e departamentit te prokurimit, komisioni vlerëson se oferta e grupit te OE INTEGRAL dhe MILENIUM KONSTRUKSION nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit për piken 9.1 kapaciteti teknike dhe prolësional.
Komisioni vlerëson se dëshmitë e ofruara nga ana e grupit te OE INTEGRAL dhe MILENIUM KONSTRUKSION për kontrata te mirëmbajtës nuk janë ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit.
Komisioni për sqarimin e kësaj pike mbështetet edhe ne vendimin e panelit shqyrtues qe sqaron se kontratat e dorëzuara janë kontrata te mirëmbajtjes dhe ne vlerësimin e komisionit te njëjtat nuk janë kontrata për pune te ngjashme siç kërkohet ne piken 9.1 te dosjes se tenderit.
Ne baze te dëshmive te dorëzuara nga ana e grupit te OE INTEGRAL dhe MILENIUM KONSTRUKSION
Rezulton se ky konzorcioum ka ofruar dëshmi për pune te ngjashme te pranueshme deri ne vlerën 2.173,499.89€.
Ne vendimin e OSHP-se paneli shqyrtues kërkon nga AK qe te kërkohet sqarim edhe për dy kontrata ne shumat respektive183.449.69€dhe63,953.67€
Komisioni i vlerëson se edhe nëse kërkohen dëshmi për këto kontrata nga ana e O.E. dhe këto kontrata të vlerësohen si të pranueshme,të njëjtat nuk do te bëni ndryshim ne plotësimin e vlerës se kërkuar sipas pikës 9.1 te dosjes se tenderit.
Nga shuma e te gjitha dëshmive te pranueshme duke përfshire edhe dy kontrata e cekura do te kishim një total prej 2,420.903.25€,qe nuk është shuma e kërkuar sipas kritereve te dosjes se tenderit.
Ne baze te argumenteve te dhëna dhe vlerësimit te bere, komisioni i vlerësimit jep rekomandimin se oferta e përgjegjshme me çmimin me te ulet është oferta e grupit te OE SABA BELCA dhe SB CONSTRUCTION dhe GURËBARDHI. e cila është ne shumen 1.747.858.50€.

nr OE	vlera	NDRYSHIMI SIPAS KERKESAVE TE DOSJES
1.Gr-OE-INTEGRAL dhe MILENIUM KONSTRUKSION	1,744.083.70€	0.00€ Oferte e papërgjegjshme (nuk plotëson kërkesat per Kapaciteti teknik dhe profesional)
2.Gr-OE- SABA BELCA dhe SB CONSTRUCTION dhe GURËBARDHI	1,747,858.50€	3.774.80€ Oferte e përgjegjshme -Rekomandohet për kontrate
3.Gr-OE-REXHA dhe RAHOVICA	1,833,542.60 €	89,458.90€ Oferte e përgjegjshëm
4.Gr-OE-GASHI ING dhe BAGERI	1,834,928.70€	90,845.00€ Oferte e përgjegjshëm
5.Gr-OE-PE-VLAKU dhe JOOS & KRASNIQI	2,384,433.91€	640,350.21€ Oferte e përgjegjshëm

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

/

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve:

Eksperti Shqyrtues sqaron se, aktiviteti i prokurimit "**Vazhdimi i rrugës B-Pjesa e dytë**" me nr të prokurimit **616-19-1015-5-1-1**, ka bërë hapjen e ofertave me datën 26.12.2019, ku pas vlerësimit të ofertave është rekomanduar **OE " Saba Belca& SB Construction SHPK& Gurëbardhi SHPK**", por pas kërkesës për rishqyrtim të OE ankuesit në fjalë **"Integral Shpk&Milenium Konstruction"Shpk,** AK ka aprovuar kërkesën për rishqyrim duke e kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim pasi ankuesi në fjalë ka sqaruar AK-së në detaje kontratat për punë të ngjashme dhe po ashtu kanë bashkangjitur ne kërkesën për rishqyrtim edhe pozicionet brenda kontratave,e ku në këto pozicione janë kryer punime dhe ndërtime të rrugëve, të cilat pozicione autoriteti kontraktues i kishte marr parasysh me rastin e rishqyrtimit dhe rivlerësimit.
Më pastaj AK-ja ka nxjerr njoftimin mbi vendimin tjetër ku ka rekomanduar ankuesin në fjalë **"Integral Shpk&Milenium Konstruction"Shpk** për kontratë. Pas këtij njoftimi kishte parashtruar ankesë në OSHP operatori ekonomik **"Saba Belca Dega në Kosovë&SBConstructionShpk&Gurëbardhi Shpk"**, ku pastaj Paneli i OSHP-së ka nxjerr një vendim **317/20 dt 10.07.2020**, ku ka kërkuar që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim:

> Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës. vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me natyrën e punëve dhe nëse kontratat e kontestuara janë brenda 3 viteve të fundit sikurse ka kërkuar AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Pas sqarimit të natyrës së këtyre kontratave dhe afateve. AK të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues tutje sqaron, se me datën 07.09.2020 AK nxjerr Vendimin mbi rekomandimin për kontratë **"Saba Belca Dega në Kosovë & SB Construction Shpk &Gurëbardhi Shpk"** ndërsa ankuesin në fjalë **"Integral Shpk&Milenium Konstruction"Shpk** e ka eliminuar si të pa përgjegjshëm me arsyetimin:

> ARSYETIM
>
> *[Ju jeni diskualifikuar]* për këto arsye :
>
> ***Nuk keni dorezuar deshmi te mjaftueshme se keni perfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndertim i ulte) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).***
>
> . . . . .

Pretendimi i OE ankuesit është:

Sa i përket arsyes së eliminimit nga ana e AK-së, ju sqarojmë se nuk është i qëndrueshëm ky arsyetim sepse ne kemi ofruar dëshmi se kemi realizuar kontrata në vlerë mbi 3,000.000.00 euro (më shumë se sa është kërkuar në FDT) dhe me dosje i keni pasur të bashkangjitura të gjitha dëshmitë si procesverbalet e pranimeve teknike, kontratat,

referencat, e ku shumë lehtë AK-ja ka mundur të verifikoj një gjë të tillë vetëm se është dashur të bëj një vlerësim më objektiv dhe jo të njëanshëm.

AK-ja në FDT ka kërkuar që të ofrohen dëshmi për kontrata të ngjashme (ndërtim i ultë) në vlerë minimale 3,000.000.00 euro, ndërsa tek dëshmitë dokumentare ka kërkuar vetëm një listë të kontratave dhe me ju bashkëngjit referencat dhe procesverbalet pranimeve teknik. Pra si kërkesë ka dykuptimësi sepse tek kërkesa shkruan të ngjashme ndërsa në kllapa ndërtim i ultë.

Termi kontrata të ngjashme është term shumë i zgjeruar dhe mund të merren edhe mirëmbajtja e rrugëve, ashtu siç e ka bërë AK-ja në një përgjigje që e cekëm më lartë. Mirëpo sidoqoftë edhe nëse eventualisht nuk i ka llogaritur si të ngjashme mirëmbajtjen e rrugëve atëherë kërkojmë nga ju që të detyroni AK që në kontratat që ne i kemi prezantuar me titull mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve-magjistraleve dhe autostradave, në brendi të tyre në paramasë ka pozicione që janë kryer ndërtim të rrugëve, asfaltim, gërmim, bankina, pahije elastik, kanalizime, mure gabione, sinjalizim etj. ti merr parasysh dhe ti konsiderojë në kuadër të ndërtimit të rrugëve-ndërtimit të ulët.

Kontratat e mirëmbajtjes janë kontrata të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo ne ju sqarojmë se në kontratat të cilat ne i kemi realizuar për mirëmbajtje ka pasur shumë punë në pozicione dhe në paramasë e që ne i kemi kryer si p.sh furnizimi me asfalt, gropëzimi etj. Gjithashtu ju sqarojmë se ne kontratat për mirëmbajtje i kemi për rrugë nacionale dhe regjionale, ku ka shumë punë edhe në riparimin dhe sanimin e dëmtimeve të mëdha të asfaltit, gabiona, pahi etj.
Po ashtu kontratat e prezantuara nga ne janë edhe për mirëmbajtjen dhe punët e kryera në Autostradën Ibrahim Rugova, ku janë të përfshira shumë pozicione që kanë të bëjnë me asfalt, kanalizim, gërmim, mbushje me zhavorr etj.

Eksperti Shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankuesit e konsideron të bazuar, për faktin se mendon që kontratat dhe pranimit teknike/procesverbalet janë të natyrës së ngjashme.

Po ashtu Eksperti Shqyrtues i kësaj lënde është bazuar edhe tek ekspertiza e kalur 317/20, ku eksperti i lëndës 317/20 ka kërkuar që të angazhohet nji ekspert teknik i profilizuar në lëminë e këtij aktiviteti për pretendimin e njejtë.

Eksperti teknik ka shqyrtuar pretendimin i cili ka qenë po i njejti sikurse tani;citat nga Ekspertiza e kaluar 317/20

*" **Përgjigje në Pretendimi nr. 1***
Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar:"Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndërtim i ulte) në vlerë minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë). SHENIM Nëse tenderuesi është grup i OE-ik lideri i grupit duhet të plotësojë 60 % të vlerës së referencave", dhe të dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve".
Duke u bazuar në paramasat e prezantuara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës "INTEGRAL SHPK & MILENIUM KONSTRUCTION SHPK", si sqarime shtesë së bashku me kërkesën për rishqyrtim, ***ekspertja teknike sqaron se kontratat e prezantuara të mirëmbajtjes, disa pozicione përfshin edhe punë të ngjashme e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë "Punë të ngjashme (ndërtim i ulte)".***
Andaj Eksperti Shqyrtues më tutje sqaron, se kontratat e bashkangjituar të mirëmbajtjes së rrugëve verore dhe dimrore kanë natyrën

e ngjajshme (ndërtim I ulët),

RAPORT PERFUNDIMTAR

I PUNIMEVE TË KRYERA NË KONTRATËN " MIRËMBAJTJA VERORE DHE DIMRORE E RRUGËVE NACIONALE DHE REGJIONALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2016-2017 -- REGJIONI PRISHTINA B;" - KONTRATA NR:072/2014;

KUMENTACIONI KONTRAKTUES

1.1 Financimi i kontratës është bërë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës - Buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës .

1.2 Për realizimin e punimeve të "Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2016/2017 " ,Regjioni PRISHTINA "B" , është lidhë kontrata me Nr:Id:072/2014 e nënshkruar me 24.14.2014,

Kontrata është lidhë në mes të Ministrisë së Infrastrukturës dhe kontraktuesit "INTEGRAL shpk.& MILENIUM KONSTRUKCION "shpk.-Prishtinë.

1.3 Kontrata është lidhë me çmim njësi dhe është :459.73 €.

1.4 Kontrata është lidhë për tri vite.(36 Muaj)

1.5 Vlera e punëve të realizuara për vitin 2016/2017 (nga 15. 11.2016 - 24.12.2017) janë në vlerë': 1,276,428.34 €.

1.6 Garancioni i punimeve, është 1 vit nga data e pranimit teknik , sipas nenit 12 të KVK (kushteve të veçanta të kontratës) .

2. DOKUMENTACIONI TEKNIK - PROJEKTET

Punimet janë kontraktuar sipas specifikimeve teknike dhe paramasës për Mirëmbajtjen Verore dhe Dimrore të rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës - Regjioni Prishtina "B". Paramasa është hartuar nga komisioni i caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës .

Sipas kontratës "Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2016/2017 " ,Regjioni Prishtina B" , janë paraparë të Mirëmbahen 159.30 km. rrugë Nacionale dhe Rajonale.

Rrugët që do të Mirëmbahen në kontratën "Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Republikës së Kosovës 2016/2017 " Regjioni Prishtina B" , ipen në vijim :

Pozicionet kryesore që janë paraparë të mirëmbahen sipas kontratës janë :

1.Punimet në sanimin e dëmtimeve në shtresat qarkulluese të asfaltit .

2.Punimiet në pastrimin dhe hapjen e kanaleve, rigolave ,lëshesave gypore dhe pilakor dhe kanalizimit atmosferik .

3.Rregullimi i bankinave dhe punimi bankinave të reja

4.Largimi i vegjetacionit në të dy anët e rrugës në gjerësi deri 4.0m nga skaji i asfaltit , largimi nga profili i rrugës i dheut të eroduar.

5.Pastrimi i shenjave , sanimi i pahive të dëmtuara , vendosja e pahive të reja , vendosja e udhërrëfyesëve të rinj dhe shënimi i vijës së bardhë (sinjalistika horizontale) .

6.Punimet e betonit(muret mbrojtëse) , punimi i llëshesave të reja , rivendosja e parmakëve të urave , rxhyrosja e parmakëve të urave , vendosja e skajorëve të parafabrikuar , largimi i kafshëve të akcedlatuara etj.

7. Sanimi i Rrëshqitëzes në rrugën Nacionale N25.2,Lokacioni te Ugoni i Badovcit,sipas paramasës së Raportit.

Mirëmbajtja Dimrore

1.Kamionet e kontraktuesit :Orët efektive dhe të udhëtimeve,Koha e kujdestarisë 24 orë

2.Furnizimi me kripë dhe rërë , ngarkimi shpërndarja e kripës dhe rërës

3.Sinjalizimi i trafikut , udhërrëfyesve , mbrojtësve të betës .

4.Punët tjëra

3.MENAXHIMI , MBIKQYRJA DHE REALIZIMI I PUNIMEVE

3.1 Menaxhimi dhe Mbikëqyrja e realizimit të kontratës është kryer nga Departamenti Për Menaxhimin e rrugëve .

Menaxher i kontratës me vendimin e Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, është caktuar Sadri Jahaj , Ing. i dip. i ndërtimtarisë . Në vendim janë përcaktuar, detyrat ,kompetencat dhe përgjegjësit e Menaxherit të Projektit.

3.2 Kryesi i Punimeve

Kryesi i punimeve është : Kompania "INTEGRAL shpk.& MILENIUM KONSTRUKCION "shpk.-Prishtinë.

4. DOKUMENTACIONI I UDHËHEQUR GJATË KRYERJES SË PUNIMEVE

4.1. Ditari ndërtimor .

Ditari ndertimor eshte udhehequr dhe eshte nenshkruar nga mbikqyresi ne menyre te rregullt.

4.2 Libri i ndërtimit

Librat e ndertimit jane te punuara sipas situacioneve te leshuara

4.2.1 Mirëmbajtja Dimrore

Gjate mirembajtjes dimrore jane mbajtur evidence te rregullta lidhur me aktivitetet dimrore, Konkretisht jane mbajtur rregullisht raportete e pastrimit dhe shperndarjes se kripes me formularet perkates. Nga librat e prezantuara shifet se janë evidentuar : Vozitsi , Numri i kamionit , Rruga dhe drejtimi i udhëtimit , kilometrat e paktruar , sasia e harxhuar e kripës dhe rërës, orët efektive dhe orët e kujdestarisë së kamionave.

4.2.2 Mirëmbajtja verore

Libri i ndërtimit është udhëhequr me rregull dhe nënshkruar nga udhëheqësi i punishtes dhe Menaxheri i projektit (organi mbikëqyrës) . Libri ndërtimor është mbajtur në fasciklа të veçanta , për secilin situacion . Nga libri i ndërtimit shifet se janë paraqitur ,

Pretendimi tjetër I OE ankuesit:

Sa për informacion ju sqarojmë se edhe raporti i komisionit të vlerësimit nuk është i nënshkruar prej tre anëtarëve të

komisionit vlerësues ashtu siç kërkohet me ligj, mirëpo njëri anëtar i komisionit nuk e ka nënshkruar fare këtë raport e ky person është z. Ylber Jashari.

Në raportin e komisionit të vlerësimit shkruan se mbështetet edhe në vendimin e paneli shqyrtues që sqaron se kontratat e dorëzuara janë kontrata të mirëmbajtjes, mirëpo për neve është e çuditshme se si e kanë shënuar se mbështeten në vendimin e panelit shqyrtues, kur ky komision nuk ka marr për bazë vendimin e panelit shqyrtues i cili e ka obliguar AK të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së në lidhje me kontratat.

Në raport të vlerësimit shkruan se dëshmi për punë të ngjashme kemi ofruar në vlerën prej:2,173,499.89 €. Ky arsyetim është shumë i pasaktë dhe jo real dhe nuk e dimë se si AK-ja i ka bërë këto përllogaritje apo vetëm ka vepruar me supozime dhe në mënyrë subjektive duke e favorizuar OE e rekomanduar për kontratë.

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e gjenë **të bazuar,**

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit	**Nënshkrimi**
Amire Krasniqi	
Ylber Jashari	
Jeton Zherka	

Data: **04.09.2020**

Pra Ekspeti Shqyrtues konsideron se kontratat për mirëmbajtje të rrugëve të paraqitura nga OE ankuesi, duhet të merren të mirëqenë nga AK (sic I ka marrë edhe në fillim pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim dhe ka kthyer Aktivitetin e Prokurimit në rivlerësim), pasi që shumicën e pozicioneve I ka të natyrës së ngjashme.

Andaj nga cka u sqarua më lartë, **mendoj** se OE ankuesi **"Integral Shpk&Milenium Konstruction"Shpk, është i përgjegjshëm** me cmimin më të lirë të përgjegjshëm, ashtu siq është shpallur në vendimin e dates 08.05.2020.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet, dhe se vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet, lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINE.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues - **OE "Integral SHPK&Milenium Konstruktion SHPK"**